



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“TEKNIKË PESHKIMI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**J2-III-17**

Tiranë, Korrik 2017

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	TEKNIKË PESHKIMI			Kodi
	Kohëzgjatja	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
	900-1100 orë			<b>J2-III-17</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në profilin “Teknikë Peshkim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të pajisë individin me njohuritë dhe shprehjet për ushtrimin e kompetencave profesionale në fushën e detarisë që ka lidhje me specifikat e punës në teknikën e peshkimit. Këto qëndrime do t’i shërbejnë për t’i dhënë mundësinë për t’u punësuar në sektorin e peshkimit, me prioritet në repartin e përgatitjes/riparimit të veglave peshkore.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në ofruesit e kualifikimeve profesionale në “Teknikë Peshkimi”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar kualifikimin profesional “Detari”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>- përvoja në det nuk duhet të jetë më pak se 2 (dy) muaj;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Teknikë Peshkimi”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë.  Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në një: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. repart përgatitje/riparimi të veglave peshkore;</li> <li>b. fermë kultivimi artificial të produkteve ujore;</li> <li>c. stabiliment mbledhje dhe përpunimi të produkteve ujore;</li> <li>d. mjet lundrimi për qëllime peshkimi me gjatësi deri në 24 metra;</li> <li>e. mjet lundrimi për qëllime kënaqësie të lundrimit bregdetar;</li> <li>f. mjet lundrimi bregdetar për qëllime kërkimore-shkencore;</li> <li>g. mjet lundrimi bregdetar i agjencive të zbatimit të ligjit.</li> </ul> Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV (manaxherial) të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, në drejtimin “Detari”, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	Nuk ka			

## **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT**

### **Rezultatet e të nxënit në:**

### **NJOHURI**

Në përfundim të kualifikimit profesional "Teknikë Peshkimi" niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi zotëron njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

#### **Etika profesionale dhe organizimi i punës**

- Të përshkruajë parimet kryesore të etikës profesionale në punë;
- Të përshkruajë rregullat e një komunikimi të suksesshëm dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
- Të listojë cilësitë e nevojshme në një sjellje dhe komunikim të suksesshëm, si dhe rëndësinë e tyre (të tilla si, iniciativa, korrektësia, vetëkontrolli, etj.);
- Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në eficiencën dhe efektivitetin, në vendin e punës;
- Të argumentojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të përshkruajë parimet kryesore të punës në grup/ekipin;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit ergonomik të punës;
- Të listojë detyrat e personelit në vendin e punës sipas hierarkisë së organizimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e dokumentacionit teknik;
- Të interpretojë rëndësinë e koordinimit të aktiviteteve me partnerë biznesi, bashkëpunëtorë e kolegë;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të legjislacionit në industrinë e peshkimit dhe rritjes artificiale.

#### **Teknikë peshkimi**

- Të përshkruajë ndërtimin, cilësitë dhe sistemet e penjve për përdorim në veglat e peshkimit;
- Të interpretojë bazat teorike të ndërtimit të veglave të peshkimit;
- Të përshkruajë faktorët që ndikojnë në kapshmërinë e veglave të peshkimit;
- Të përshkruajë gjeometrinë e rrjetës;
- Të interpretojë paraqitjen skematike të veglave të peshkimit;
- Të interpretojë forcat vepruese në veglën e peshkimit statike dhe në atë në lëvizje;
- Të përshkruajë metodën grafo-analitike dhe të modelimit për njehsimin e mjeteve të gjuetisë së peshkut;
- Të interpretojë bazat e përgjithshme të ndërtimit të veglave të peshkimit dhe teknikën e peshkimit me to;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të rrjetave të peshkimit syzëpërfshirëse, me një, tre perde dhe kornizë;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të veglave të hapura rrethuese të gjuetisë së peshkut;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të veglave stacionare lumore/bregdetare për gjuetinë e peshkut;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të rrjetave të peshkimit me trata kiçi fundor me tërheqje, të tipit "dallëndyshe", "skifter", "6 panelëshe", "francez", "italian", "amerikan", etj.;
- Të interpretojë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimin e punës në gjuetinë me trata kiçi;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të veglave të mbyllura rrethuese të gjuetisë së peshkut sardel ton, etj.
- Të interpretojë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimin e punës me vegla të mbyllura rrethuese

- të gjuetisë së peshkut sardele, ton, etj.;
- Të interpretojë teorinë e ndërtimit të rrjetave të peshkimit të tratave pellagjike (mesujore) me tërheqje;
- Të interpretojë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimin e punës në gjuetinë me trata pellagjike (mesujore) me tërheqje;
- Të përshkruajë kriteret e gjuetisë me vegla pasive si kosh, gracka dhe kutia notuese;
- Të përshkruajë shërbimet për jetëgjatësinë e materialeve dhe veglave të peshkimit në kushtet e anijes;
- Të identifikojë procedurat e vlerësimit të një defekti apo mangësie të veglës së peshkimit.

### **Teknologjia e peshkut, profilaksia dhe gjenetika**

- Të diskutojë si sistemohet dhe seleksionohet peshku mbas gjuetisë;
- Të përshkruajë kushtet e ruajtjes së peshkut në frigorifer, në kriposje, tymosje etj.
- Të dallojë sëmundjet kryesore që evidentohet tek peshqit;
- Të dallojë shenjat e peshqve të sëmurë nga ato normale;
- Të argumentojë masat profilaktike për shmangien e sëmundjeve tek peshqit;
- Të përshkruajë shkaqet që çojnë në helmim, traumatizim, asfiksi dhe atrofizim të peshqve;
- Të përshkruajë masat profilaktike për shmangien e helmimit, traumatizimit, asfiksionit dhe atrofizimit të peshqve;

### **Rritje artificiale**

- Të listojë kriteret për seleksionimin e riprodhuesve që japin rendiment të lartë;
- Të përshkruajë shenjat e afshit seksual të riprodhuesve të peshqve bar-plankton ngrënës;
- Të rendisë hapat e punës për fekondimin artificial të peshqve bar-plankton ngrënës;
- Të përshkruajë hapat e punës për hedhjen e vezëve të fekunduara në inkubatorin e çeljes së larvave;
- Të përshkruajë shenjat e kohës së çeljes së larvave në varësi të faktorëve të ndryshëm;
- Të përshkruajë hapat e punës për përgatitjen dhe dhënien e ushqimit të larvave;
- Të rendisë hapat e punës për përgatitjen dhe dhënien e ushqimit të rasateve;
- Të rendisë hapat e punës për plehërimin e pellgut të riprodhuesve në kohën e duhur;
- Të rendisë ushqimet koncentrate si dhe kombinacionet që përdoren në recetat ushqimore;
- Të përshkruajë hapat e punës për kultivimin e familjes së qefujve, koces, levrekut, ngjalës, etj. në bregdet.

### **Hidro bio-kimi**

- Të përshkruajë vetitë fiziko kimike të ujërave;
- Të përshkruajë parimet dhe shtresat e përhapjes së dritës në ujëra;
- Të vlerësojë përqendrimet e planktonit, fitoplanktonit dhe zooplanktonit duke parë ujin me sy të lirë;
- Të përshkruajë faktorët ndikues në ndryshimin e nivelit të oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në pellgje;
- Të përshkruajë natyrën dhe efektet e ndotjeve të ujërave në jetën e organizmave ujorë;
- Të përshkruajë ndikimin e elementeve kimikë të ujërave në jetën e peshqve.

### **Lundrim**

- Të dallojë formën dhe lëvizjen e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit

- Të përshkruajë veçoritë e magnetizmit tokësor, busullën magnetike, ndikimi i saj mbi anije.
- Të llogarisë korrigjimin dhe kthimin e kurseve dhe pelengjeve.
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së largësive dhe thellësive në lundrim;
- Të përshkruajë projeksionet hartografike, shkallën e hartave, leximin e tyre dhe shtrimin grafik;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit kur përdoren pajisje me hartë elektronike dhe të sistemit informativ;
- Të përshkruajë veçoritë e erërave dhe rrymave detare dhe ndikimin e tyre tek anija në lundrim;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit të anijes në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj.;
- Të përshkruajë veçoritë e fenerëve detar dhe karakteristikave të tyre;
- Të përshkruajë funksionet e treguesve të xhirove të motorit, të lëvizjes dhe të drejtimit të anijes;
- Të listojë literaturën kryesore navigacionale bazë të nevojshme;

#### **Aspekte të legjislacionit detar**

- Të përshkruajë dokumentacionin e një mjeti lundrimi para daljes në det dhe me ardhjen nga deti;
- Të përshkruajë parimet e reagimit dhe hetimit të aksidenteve/incidenteve detare, sipas Kodit të IMO<sup>i</sup>-s;
- Të përshkruajë parimet bazë, llojet dhe kushte nga policat e siguracioneve detare;
- Të përshkruajë procedurat dhe aktorët në raste të ndotjeve në det sipas Planit Kombëtar të Reagimit;

#### **Pajisje Radio-Navigacionale**

- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Radarit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e autopilotit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e GPS<sup>ii</sup>-së në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Thellësimatësit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Navtex<sup>iii</sup>-it në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e AIS<sup>iv</sup>-it në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës, funksionin dhe përditësimet e pajisjeve ECDIS<sup>v</sup> të lundrimit me hartë elektronike;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Blue Box<sup>vi</sup>-it në anijen e peshkimit;
- Të përshkruajë parimin e punës, frekuencat, funksionin dhe rregullat e komunikimit detar me Radion e instaluar dhe të lëvizshme të bandës VHF<sup>vii</sup> në mjetin e lundrimit;

#### **Elektro-mekanikë në anije**

- Të përshkruajë funksionin, hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e moto-gjeneratorëve;
- Të përshkruajë funksionet, hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e agregateve të instaluar si pompa elektrike dhe/ose pompa hidraulike në funksion të shërbimeve në det;
- Të përshkruajë funksionin, hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e kompresorëve për mbushjen e bombolave të ajrit;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e valvolave, tubacioneve, saraçineskave, pajollave në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e kapakëve të depove/tankeve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e punës për eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet në anije;

- Të përshkruajë hapat e punës për thithjen dhe nxjerrjen jashtë tek impiantet marrëse portuale të mbeturinave hidro-karbure në anijes si sentina, llumra nga separatori, vaji i djegur, etj.
- Të shpjegojë masat e sigurisë për punime saldimi në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë markimet e sistemeve dhe agregateve të instaluar në anije;
- Të rendisë hapat e punës për marrjen e masave për furnizimin me karburant dhe ujë;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Teknikë Peshkimi” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi zotëron shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Etika profesionale dhe organizimi i punës**

- Të zbatojë normat e etikës profesionale në punë;
- Të sigurohet për marrjen e masave për sigurinë, shëndetin, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri para fillimit të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- Të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Të raportojë tek eprori për konstatimet;
- Të informojë qartë, me zë të lartë, me mjete komunikimi të disponueshme për t’u siguruar që u kuptua;
- Të mirëmbajë vendin e punës;
- Të bashkëpunojë në grup duke kuptuar mirë rolin e tij dhe të kolegëve;
- Të identifikojë dokumentacionin teknik përkatës;
- Të mbajë shënimet për rezultatet e punimeve të kryera qartë dhe saktë;

### **Teknikë peshkimi**

- Të skicojë një vegël peshkimi syzëpërfshirëse, me një, me tre perde dhe kornizë
- Të llogarisë materialet e nevojshme për një vegël peshkimi syzëpërfshirëse, me një, me tre perde dhe kornizë;
- Të përgatisë një vegël peshkimi një vegël peshkimi syzëpërfshirëse, me një, me tre perde dhe kornizë;
- Të skicojë një vegël stacionare lumore/bregdetare për gjuetinë e peshkut;
- Të llogarisë materialet e nevojshme për një vegël stacionare lumore/bregdetare për gjuetinë e peshkut;
- Të përgatisë një vegël peshkimi një vegël stacionare lumore/bregdetare për gjuetinë e peshkut;
- Të skicojë një maket vegle peshkimi të llojit tratë kiçi fundor me tërheqje sipas një modeli të caktuar;
- Të llogarisë materialet e nevojshme për një maket vegle peshkimi të llojit tratë kiçi fundor me tërheqje sipas një modeli të caktuar;
- Të përgatisë një maket vegle peshkimi të llojit tratë kiçi fundor me tërheqje sipas një modeli të caktuar;
- Të skicojë një vegël peshkimi pasive të llojit kosh, grackë dhe kuti notuese;
- Të llogarisë materialet e nevojshme të një vegle peshkimi pasive të llojit kosh, gracka dhe

kutia notuese;

- Të përgatisë një vegël peshkimi një vegël peshkimi pasive të llojit kosh, gracka dhe kutia notuese;

### **Teknologjisë se peshkut, profilaksisë dhe gjenetikes**

- Të sistemojë dhe seleksionojë peshkun mbas gjuetisë;
- Të veprojë si individ apo në grup për ruajtjen e peshkut në frigorifer, për kriposjen, për tymosjen, etj.;
- Të dallojë individët e sëmurë tek peshqit;
- Të dallojë individët e peshqve të helmuar, traumatizuar, asfiksuar dhe atrofizuar;
- Të marrë masa profilaktike për shmangien e sëmundjeve tek peshqit;
- Të marrë masa profilaktike për shmangien e helmimit, traumatizimit, asfiksionit dhe atrofizimit të peshqve.

### **Rritje artificiale**

- Të seleksionojë riprodhuesit që japin rendiment të lartë në bazë të shenjave përkatëse;
- Të dallojë shenjat e afshit seksual të riprodhuesve të peshqve bar-plankton ngrënës;
- Të marrë masat për fekondimin artificial të peshqve bar-plankton ngrënës;
- Të hedhë vezët e fekunduara në inkubatorin e çeljes së larvave;
- Të llogarisë kohën e çeljes në varësi të faktorëve si temperatura, shpejtësia e lëvizjes së ujit;
- Të përgatisë ushqimin dhe ushqejë larvat;
- Të përgatisë ushqimin dhe ushqejë rasatet;
- Të jetë pjesë aktive në plehërimin e pellgut të riprodhuesve në kohën e duhur;
- Të përdorë ushqimet koncentrate si dhe kombinacionet në recetat ushqimore;
- Të marrë pjesë aktive për kultivimin e familjes së qefujve, koces, levrekut, ngjalës, etj. në bregdet;

### **Hidro bio-kimi**

- Të vlerësojë përqendrimet e planktonit, fitoplanktonit dhe zooplanktonit duke parë ujin me sy të lirë;
- Të masë faktorët që ndikojnë në ndryshimin e nivelit të oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në pellgje;

### **Lundrim**

- Të manovrojë me timonin sipas komandës së dhënë;
- Të kalojë nga drejtimi me busull magnetike në autopilot dhe anasjelltas sipas komandës së dhënë;
- Të identifikojë drejtimet e lëvizjes së mjetit lundrues në det;
- Të identifikojë këndet kursore të objekteve që janë përreth mjetit lundrues;
- Të raportojë objektet dhe dinamikën e tyre, që sheh dhe dëgjon nga vëzhgimi përreth mjetit lundrues;
- Të kryejë një patrullim në mbistrukturë gjatë lundrimit;
- Të kryejë hedhjen/ngritjen e spirancës së mjetit lundrues;
- Të identifikojë një fener detar në bazë të karakteristikave;
- Të përdorë pelengatorin për përcaktim vendndodhjeje me objekte bregdetare;
- Të përcaktojë vendndodhjen e anijes me metoda të ndryshme;

- Të përgatisë dokumentacionin e duhur për lundrim për gjueti peshku;
- Të interpretojë treguesit e xhirove të motorit, të lëvizjes dhe drejtimit të anijes;
- Të kryejë detyra që i cakton kapiteni kur anija lundron në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica, etj.
- Të përdorë literaturë navigacionale në funksion të lundrimit;
- Të hedhë në hartë kursin e lëvizjes për në zonën e planifikuar të peshkimit;

### **Pajisje Radio-Navigacionale**

- Të interpretojë leximet e radarit;
- Të interpretojë leximin e GPS-së;
- Të interpretojë leximin e Thellësimatësit, përfshirë për qëllime gjuetie peshku;
- Të interpretojë leximin e Navtex-it në anije;
- Të interpretojë drejtimin e lëvizjes dhe pozicionin e mjetit lundruar duke lexuar një hartë elektronike në ekranin e pajisjes ECDIS;
- Të përdorë Radion e instaluar dhe të lëvizshme të bandës VHF në anije;
- Të përdorë sipas udhëzimit Blue Box-in në anijen e peshkimit;

### **Elektro-mekanikë në anije**

- Të ndezë dhe fikë moto-gjeneratorët;
- Të ndezë dhe fikë agregate të instaluar si pompa elektrike dhe/ose pompa hidraulike në anije;
- Të ndezë dhe fikë kompresorët në funksion të mbushjes së bombolave të ajrit;
- Të çmontoje dhe montojë valvola dhe saraçineska të ndryshme në lokalin e makinerisë dhe kuvertë;
- Të çmontoje dhe montojë tubacione të ndryshme të dëmtuar në lokalin e makinerisë dhe kuvertë;
- Të çmontoje dhe montojë kapakë të depove/tankeve të ndryshme në lokalin e makinerisë dhe kuvertë;
- Të marrë masat për eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet të ndryshme në anije;
- Të çmontoje dhe montojë pajollat në lokalin e makinerisë;
- Të asistojë për thithjen dhe nxjerrjen jashtë tek impiantet marrëse portuale të mbeturinave hidro-karbure në anijes si sentina, llumra nga separatori, vaji i djegur, etj.
- Të marrë masat e sigurisë për punime saldimit në lokalin e makinerisë;
- Të markojë përkatësisht e sistemet dhe agregatet e instaluar në lokalin e makinerisë në anije;
- Të asistojë në marrjen e masave për furnizimin me karburant dhe ujë;

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;



- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

---

<sup>i</sup> IMO- Organizata Ndërkombëtare Detare

<sup>ii</sup> GPS – Sistemi i Pozicionimit Global

<sup>iii</sup> NAVTEX – Teleks lundrimor për marrje informacioni nga stacionet bregdetare

<sup>iv</sup> AIS – Sistemi i Identifikimit Automatik

<sup>v</sup> ECDIS – Sistemi i Informimit me Hartë Elektronike në Ekran

<sup>vi</sup> Blue Box – Pajisje elektronike për transmetim të dhënash nga gjuetia, pozicioni, etj. stacionit bregdetar

<sup>vii</sup> VHF – Frekuencë Shumë e Lartë